



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 14648 prot.

Vlorë, më 20.09 2024

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë, \_\_\_\_\_.\_\_\_\_ 2024

**“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “VLORA PARKING” SH.A SI PERSON JURIDIK NË  
PRONËSI TË BASHKISË VLORË DHE MIRATIMIN E STATUTIT”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2, neni 9/1, pika 1/b dhe 7/a, neni 54, pika m, ne Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ligji nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), neni 35 pika 2 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);

**V E N D O S I:**

1. Krijimin e shoqërisë me emërtimin tregtar “VLORA PARKING” sh.a, shoqëri aksionere, e zotëruar në masën 100 (njëqind) % të kapitalit të shoqërisë nga Bashkia Vlorë me objekt veprimtarie:
  - Menaxhimin e shërbimit të parkimit publik në qytet.
2. Shoqëria “VLORA PARKING” sh.a themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri sh.a, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

3. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “VLORA PARKING” sh.a, të jetë 3.500.000 lekë.
4. Bashkia Vlorë është ortaku i vetëm themelues, i cili zotëron 100 (njëqind) % të kapitalit themeltar të shoqërisë “VLORA PARKING” sh.a. të barabartë me një kuotë me vlerë të përgjithshme prej 3.500.000 lekë.
5. Shoqëria “VLORA PARKING” sh.a, fillimisht të ketë selinë qendrore pranë Bashkisë Vlorë.
6. Shoqëria “VLORA PARKING” sh.a. të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.
7. Pas miratimit të kërkesës për themelimin e shoqërisë aksionare themeluesi cakton Administratorin/Administratorët për herë të parë.
8. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 3.500.000 lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2024.
9. Bashkia Vlorë, Drejtoria e Finances, Buxhetit dhe Kontabilitetit angazhohet në mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit.
10. Bashkia Vlorë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë “VLORA PARKING”, sh.a. në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
11. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij, që të përfaqësojë Bashkinë Vlorë, në cilësinë e aksionarit të vetëm për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
12. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Ky Projekt - Vendim hyn në fuqi menjëherë sipas Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 14648 prot.

Vlorë, më 20.09 2024

RELACION

**“MBI PROJEKT-VENDIMIN “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “VLORA PARKING” SH.A SI PERSON JURIDIK NË PRONËSI TË BASHKISË VLORË DHE MIRATIMIN E STATUTIT”**

**PARA KËSHILLIT TË BASHKISË**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Projekt -Vendimi që ju paraqesim për miratim **“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “VLORA PARKING” SH.A SI PERSON JURIDIK NË PRONËSI TË BASHKISË VLORË DHE MIRATIMIN E STATUTIT”**, vjen si synim i Bashkisë Vlorë në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit dhe strategjisë së transportit dhe lëvizshmërisë, e cila ka identifikuar nevojat aktuale dhe të së ardhmes për parkim.

Si një nga prioritetet kryesore, Bashkia e Vlorës po i kushton një vëmendje të veçantë transportit dhe vendparkimet e qytetit në përputhje me nevojat e komunitetit, vlerësimin e alternativave për përmirësimin e shërbimit dhe sistemit të parkimit, duke konkretizuar rrugët për arritjen e këtyre objektivave duke u mbështetur në teknologjitë më inovative të cilat janë sot në treg, për përmirësimin e situatës aktuale ku ndodhet parkimi në rrugët e qytetit tonë.

Aktualisht Bashkia Vlorë operon me shërbim parkimi me pagesë në një shkallë të vogël dhe konkretisht:

- Lejon parkim me pagesë të cilat administrohen nga DIIP vetëm për një kategori të caktuar subjektsh fizikë dhe juridikë.

Duke marrë shkas nga situata e rënduar e trafikut dhe e ndotjes që qyteti po përjeton vitet e fundit nga shtimi i numrit të makinave që qarkullojnë si nga banorët e përhershëm por edhe nga ata sezonal, lind domosdoshmëri gjetja e mënyrës së rregullimit të trafikut, disiplinimit të përdoruesve të makinave si atyre që qarkullojnë por edhe atyre që parkojnë gjatë rrugëve kryesore.

Gjendja aktuale e parkimeve në rrugët e qytetit lë shumë për të dëshiruar pasi në të gjitha rrugët e qytetit mbizotëron një kaos i vërtetë si në zënien e hapësirave në rrugë, duke parkuar në cdo vend pa respektuar asnjë kriter dhe asnjë rregull, por dhe duke shtuar në mënyrë të ndjeshme trafikun e lëvizjes në qytet. Kjo sjell në mënyrë të drejtpërdrejtë kosto në xhepat e qytetarëve, rritjen e niveleit të ndotjes së ajrit në qytet, pengesë serioze në lëvizjen e autoambulancës, zjarrfikëseve, autobuzave dhe mikrobuzave të nxënësve të shkollave, pra ndikon drejtpërdrejtë në kushtet themelore të jetesës së qytetarëve.

Duke analizuar dhe kapacitetet e bashkisë, konkretisht të Drejtorisë së Infrastrukturës së Shërbimeve Publike e cila nuk ka kapacitetin e duhur për menaxhimin e këtij shërbimi, propozojmë zbatimin e një skeme të re parkimi, në rrugët kryesore të qytetit si dhe edhe zbatimin e kontrollit në shërbimin e parkimit si për rrugët kryesore por edhe ato dytësorë, me një parashikim në të ardhmen duke përfshirë edhe hapësira të tjera publike sic janë sheshet në zona të ndryshme, ekzistuese apo të krijuara rishtazi.

Nisur nga sa më lart, administrata e bashkisë e vlerëson të domosdoshme krijimin e një shoqërie aksionere për mirëmenaxhimin e hapësirave publike të destinuara për parkim e cila do të sjellë jo vetëm rritjen e cilësisë së shërbimit por edhe ndikimin në rritjen e të ardhurave në buxhetin e bashkisë Vlorë, të cilat do të përkthehen në investime në shërbim të komunitetit.

Parkimi si në rrugë ashtu edhe jashtë rruge është një aspekt i rëndësishëm dhe shumë kritik për një qytet, veçanërisht për një qytet qendër të aktiviteteve sportive, sociale dhe ekonomike si Vlora.

Strategjia e Transportit në Qytetin e Vlorës është e lidhur ngushtësisht me parkimin në dhe jashtë rruge, ku politika e vendosur mund të luajë një rol rregullator duke inkurajuar komunitetin të përdorë transportin publik apo atë privat faktorë të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në trafikun e qytetit.

Shoqëria “VLORA PARKING” sh.a synon të ketë një rol ekzekutiv në lidhje me zbatimin e politikave të parkimit të hartuara nga Bashkia e Vlorës.

Detyrat kryesore të kësaj Shoqërie janë:

- Të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Vlorës.
- Të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për funksionimin dhe shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Vlorës.
- Të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë.

Krijimi i “VLORA PARKING” sh.a ka si objektiva kryesore:

- Menaxhimin e shërbimit të parkimit publik në qytet.
- Lehtësimin e trafikut për uljen e ndotjes atmosferike.
- Nxitjen dhe përdorimin e transportit publik.
- Zhvillimin dhe cilësinë e mjedisit.
- Përdorimin e hapsirës urbane.
- Përmirësimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale (nepermjet mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e shërbimit)

Duke ju referuar disponibilitetit të hapsirave rrugore për vendparkime në qytetin e Vlorës, me qëllim administrimin e parkimit në këto rrugë, do të vendosen disa kritere për përcaktimin e vendeve të destinuara për parkim dhe të krijohen zonat e parkimit të kontrolluar (me ose pa pagesë) për parkimin në rrugë.

Në këto kushte, kërkojmë prej jush miratimin e këtij Projekt-Vendimi duke shpresuar në një vendimmarje pozitive në shërbim të komunitetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**



**STATUTI I SHOQËRISË**  
**“VLORA PARKING” SH. A, VLORË**

Sot më datë, \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024, mbështetur në legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe në veçanti në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, hartoj statutin e përditësuar të shoqërisë Vlora Parking, sh.a.

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

Shoqëria “Vlora Parking”, sh.a, Vlorë themelohet si person juridik i të drejtës shqiptare.

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria Vlora Parking Sh.a, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Bashkia Vlorë.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka selinë pranë Bashkisë Vlorë.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: [www.vlora.gov.al](http://www.vlora.gov.al), email: [info@vlora.gov.al](mailto:info@vlora.gov.al)

SHKIA VLU

## **Neni 4**

### **Objekti i veprimtarisë**

Kjo shoqëri do të ushtrojë aktivitetin e saj në:

1. Menaxhimin e shërbimit të parkimit publik në qytet.
2. Lehtësimin e trafikut për uljen e ndotjes.
3. Nxitjen dhe përdorimin e transportit publik siç parashikohet në ligj.

## **Neni 5**

### **Të drejtat e shoqërisë**

Shoqëria “Vlora Parking”, sh.a nuk përgjigjet për detyrimet që rrejdhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare, apo industriale që aksionarët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë, kohëzgjatjen, objektin e veprimtarisë, administratorin sipas vendimeve sipas vendimeve që do marrin aksionerët.

## **Neni 6**

### **Detyrat e shoqërisë**

1. Administrimi i shërbimit të parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Vlorës.
2. Të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Vlorës.
3. Të instalojë dhe të mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë.
4. Të instalojë dhe mirëmbajë sinjalistikën rrugore të parkimit
5. Të konstatojë dhe vendosë gjoba për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimin përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit.
6. Të arkëtojë gjokat e vëna në kuadër të konstatimit të një kundërvajtje administrative për shkelje që kanë të bëjnë me parkimin.

7. Të kryejë çfarëdo lloji aktiviteti tjetër që nuk bie në kundërshtime që lidhen direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale.

#### **Neni 7**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore: Pa afat.

### **KREU II**

### **KAPITALI**

#### **Neni 8**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.500.000 mijë lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga “aksionari i vetëm i shoqërisë”: Bashkia Vlorë.

Vlora Parking, zoterues i kapitalit 3.500.000 Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali aksionar është i përbërë nga 1.000 mijë aksione, me vlerë nominale 3.500 lekë për aksion.

#### **Neni 9**

#### **Kërkesa për të paguar aksionet**

Administratorët mund t'u kërkojnë aksionarëve pagimin e kontributeve të pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.



## Neni 10

### Llojet dhe kategoritë e aksioneve

Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në Asamblenë e Përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë.

Aksionet me përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj apo në statut. Aksionet, që japin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me të drejtë vote dhe aksione pa të drejtë vote).

## Neni 11

### Rregjistri i aksioneve

Shoqëria aksionare mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrit të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin *on-line* të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

## Neni 12

### Zmadhimi i kapitalit

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.

Kur emetohen aksione të reja, këto aksione i'u ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja i'u ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpara ofertës. Oferta që i'u bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh pas publikimit në QKR. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që

zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.

Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.

Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të vitit parardhës, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

## **Neni 13**

### **Zvogëlimi i aksionit**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të ligjit 9901.

Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlqimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përmbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të këtij ligji.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulimit aksionesh.

Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

## **Neni 14**

### **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve**

1. Aksionet e një shoqërie aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të këtij ligji.

ASHKIAVO

### KREU III

#### Neni 15

#### ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Organet e shoqërisë;

- Asambleja e përgjithshme;
- Këshilli mbikqyrës
- Administrator

Emërimi/shkarkimi i administratorit bëhet nga Këshilli Mbikqyrës.

#### Neni 16

#### Organi Vendimarrës

Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
  1. Ndryshimet e statutit;
  2. Emërimin e shkarkimin e administratorëve
  3. Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  4. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe ç" të kësaj pike
  5. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare dhe administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
  6. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
  7. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
  8. Pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
  9. Ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
  10. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
  11. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

12. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
13. Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporte vetë ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## **Neni 17**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë aksionerëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionerët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 18

### Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorunit të parashikuar nga neni 144 i Ligjit.

Gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme përgatitet lista e aksionarëve të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave, që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës.

Kjo listë u vihet në dispozicion aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre dhe nënshkruhet prej tyre. Asambleja e përgjithshme cakton një kryetar.

Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, aksionarët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetari të mbledhjes.

Administratori ose anëtari i Këshillit të Administrimit pavarësisht se nuk është aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe në mbledhjet e veçanta të aksionarëve, zotëruar të aksioneve të klasave të ndryshme.

## Neni 19

### Kuorumi

Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur Asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 145 të Ligjit 9901, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 142 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 20

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të aksionarëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të aksionerëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të parashikuara në nenin 14 të këtij statuti si më poshtë:

1. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
2. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
3. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
4. përcaktimin e shpërblimeve
5. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore
6. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
7. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 21

### Këshilli Administrimit

Asambleja e Përgjithshme cakton tre ose më shumë, por jo më shumë se 21, persona fizikë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, në pajtim me shkronjën "c", pika 2 të nenit 135 dhe pikën 2 të nenit 155 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë votash, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.

Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të jenë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë, në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktojnë një person i cili dëshiron të veprojë në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Administrimit, duke pasur parasysh se emërimi nuk përbën zmadhim të numrit të anëtarëve, të përmendur në pikën 1 të këtij neni. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në këtë mënyrë do të jetë në detyrë deri në mbledhjen vjetore vijuese të Asamblesë së Përgjithshme.

Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme, sipas shkronjës "c", pika të nenit 135 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (I ndryshuar).

Përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët 1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1, shkronjat "b" deri në "g" e " dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji.

2. Në bazë të parashikimeve të statutit, administratorët mund të emërohen dhe shkarkohen, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 158 të këtij ligji, nga Asambleja e Përgjithshme apo nga Këshilli Mbikëqyrës. Së bashku me funksionet e pikave 3, 4 e 5 të nenit 158 të këtij ligji, administratorët kanë të drejtë e duhet të kryejnë edhe funksionet e përcaktuara në shkronjat "a", "gj", "h" e të pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji. Me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 13 dhe nga shkronja "e" e pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji, veprimet e administratorëve u nënshtrohen miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht në statut.

3. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës administratorët e shoqërisë administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.

4. Parashikimet e neneve 155 e 157 të këtij ligji zbatohen edhe për numrin e anëtarëve, emërimin, përbërjen dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, me përjashtimet vijuese: a) anëtarët e këshillit nuk duhet të kryejnë funksione administrimi dhe shumica e tyre duhet të jenë të pavarur; b) statuti mund të parashikojë që disa prej tyre mund të zgjidhen dhe/ose shkarkohen nga punëmarrësit e shoqërisë.

5. Nenet 160, 161 dhe 162 të këtij ligji zbatohen edhe për shpërblimin, organizimin e brendshëm dhe marrjen e vendimeve nga këshilli mbikëqyrës.

6. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe standardit të kujdesit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 163 të këtij ligji. Për shkeljet e kryera nga

administratorët, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 163 të këtij ligji, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë përgjegjës, kur nuk njoftojnë Asamblenë e Përgjithshme, edhe pse kanë dijeni për këto shkelje.

## Neni 22

### Kompetencat e Këshillit të Administrimit dhe Komiteteve të tij

1. Në sistemin e administrimit me dy nivele, administratorët drejtojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa Këshilli Mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.
2. Në përputhje me rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve, sipas pikës 1 të këtij neni, dispozitat e neneve 154 deri në 165 të këtij ligji gjejnë zbatim edhe për marrëdhëniet ndërmjet administratorëve dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, ku funksionet e këtij këshilli, në përputhje me nenin 167 të këtij ligji, u korrespondojnë funksioneve mbikëqyrëse të Këshillit të Administrimit.
3. Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1, shkronjat “b” deri në “g” e “i” dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji.
4. Në bazë të parashikimeve të statutit, administratorët mund të emërohen dhe shkarkohen, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 158 të këtij ligji, nga Asambleja e Përgjithshme apo nga Këshilli Mbikëqyrës. Së bashku me funksionet e pikave 3, 4 e 5 të nenit 158 të këtij ligji, administratorët kanë të drejtë e duhet të kryejnë edhe funksionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “gj”, “h” e “i” të pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji. Me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 13 dhe nga shkronja “e” e pikës 1 të nenit 154 të këtij ligji, veprimet e administratorëve u nënshtrohen miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht në statut.
5. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës administratorët e shoqërisë administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji.
6. Parashikimet e neneve 155 e 157 të këtij ligji zbatohen edhe për numrin e anëtarëve, emërimin, përbërjen dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, me përjashtimet vijuese:



a) anëtarët e këshillit nuk duhet të kryejnë funksione administrimi dhe shumica e tyre duhet të jenë të pavarur;

b) statuti mund të parashtojë që disa prej tyre mund të zgjidhen dhe/ose shkarkohen nga punëmarrësit e shoqërisë.

5. Nenet 160, 161 dhe 162 të këtij ligji zbatohen edhe për shpërblimin, organizimin e brendshëm dhe marrjen e vendimeve nga këshilli mbikëqyrës.

6. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe standardit të kujdesit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 163 të këtij ligji. Për shkeljet e kryera nga administratorët, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 163 të këtij ligji, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë përgjegjës, kur nuk njoftojnë Asamblenë e përgjithshme, edhe pse kanë dijeni për këto shkelje, apo kur nuk i kanë zbuluar ngaqë funksioni i mbikëqyrjes, sipas kërkesave të këtij ligji, nuk është kryer në mënyrë korrekte e sipas standardeve të kërkuara.

## Neni 23

### Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

1) Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit.

2) Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me kuorumin e përcaktuar në nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtarë në momentin e emërimit.

3) Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Administratori nuk mund të emërohet si Kryetar i Këshillit të Administrimit. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit të Administrimit në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare. Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, pavarësisht nëse bëhet e ditur më pas se emërimi i anëtarit të Këshillit të Administrimit ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllor sikur këta persona të ishin

emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit të Administrimit dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

5) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose të komitetit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose në komitetin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.

## **Neni 24**

### **Procesverbali i Mbledhjes së anëtarëve të Këshillit të Administrimit**

Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të mundësojnë mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve në libra të posaçëm për:

1. të gjithë emërimet e kryera nga anëtarët e Këshillit të Administrimit; dhe
2. të gjithë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve së aksioneve të klasave të ndryshme, dhe mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe komiteteve të Këshillit të Administrimit, përfshirë edhe emrat e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të pranishëm në këto mbledhje.

## **Neni 25**

### **Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit**

Detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit përfundon në rast se:

personi nuk është më anëtar i Këshillit të Administrimit në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë Nenin 157 dhe pikën 7 të nenit 158.

personi ndodhet në gjendje paaftësie pague;e;

personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;

personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose

ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Administrimit në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Këshilli i Administrimit vendos ta shkarkojë nga detyra.

## Neni 26

### Kompetencat e Administratorëve



Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratores janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.



## Neni 27

### **Përgjegjësitë e Administratorit.**

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit 'Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare', kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen aksionerëve kontributet;
- b) u paguan aksionerëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, aksionerët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## Neni 28

### Shkarkimi i Administratorëve

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. Personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme në pajtim me pikën 2 të nenit 167, dhe shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit;
2. Personi gjendet në paaftësi paguese.
3. Personi vuan ose mund të vuaj nga çrregullime mendore.
4. Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë ose ka munguar më shumë së 6 muaj rradhazi pa lejen e Këshillit të Administrimit në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe.
5. Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkoj nga detyra

## Neni 29

### Administrimi

1. Këshilli i Administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë.

Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin.

2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm.

### **Neni 30**

#### **Këshilli Mbikqyrës**

1. Anëtarë të Këshillit Mbikqyrës emërohen në këtë detyrë nga Asambleja e Përgjithshme për një afat 3 vjecar me të drejtë ripertëritje.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës do të jenë si më poshtë:

- |                      |         |
|----------------------|---------|
| 1. Zambak Selmani    | Kryetar |
| 2. Orest Ruçi        | Anëtar  |
| 3. Emiljano Ismailaj | Anëtar  |

3. Eksperti Kontabël emërohet çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme.

## KREU IV

### DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

#### Neni 31

##### Dividendët

- 1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.
- 2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividenti. Të gjithë dividetët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividenti; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividenti do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.
- 4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

#### Neni 32

##### Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash sipas kuorumit të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapital.

## KREU V

### VITI FINANCIAR-ESKPERTËT

#### Neni 33

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor të po atij viti.

#### Neni 34

##### Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko - tregtare të shoqërisë, të gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e aksionerëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka



## KREU V

### PRRISHJA DHE LIKUJDIMI

#### Neni 35

#### Prishja dhe Likuidimi

1. Shoqëria aksionare priset:

- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- ç) me vendim gjykate;
- d) për arsye të tjera të parashikuara në statut.

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

#### Neni 36

#### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## Neni 37

### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

## Neni 38

### Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 2 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike.  
Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga aksionari themelues i shoqërisë tregtare.

## AKSIONARI I VETËM

Bashkia Vlorë

